



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 15 dhjetor 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	Metaj	Zëvendëskryetar (mungesë)
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Heqjen e licencës të shoqërisë “TV LOKAL ANTENA NORD” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Antena Nord”. **(Vendimi nr. 132, datë 15.12.2022).**
2. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit shoqërisë “Netsyscom” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor “Netsyscom”. **(Vendimi nr. 133, 15.12.2022)**
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “KL-ED KABELL” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor KL-ED” dhe miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë. **(Vendimi nr. 134, 15.12.2022).**
4. Kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca e subjektit person fizik Alessia Vogli, për shërbimin e programit audioviziv “TV Klaudiana”, tek shoqëria “Thematic Information Broadcasting Operator” sh.p.k. **(Vendimi nr. 135, 15.12.2022).**
5. Kalimin e të drejtave të autorizimeve të shoqërisë “Albtelecom” sh.a., për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv, të të tretëve online mbështetur në rrjet IP (IPTV), (OTT) dhe “Info Channel” tek shoqëria “One TeleCommunications” sh.a. **(Vendimi nr. 136, datë 15.12.2022)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 15 dhjetor 2022